


# Broshurë për pacientët/pacientet lidhur me ligjin „Për ndihmat dhe masat mbrojtëse në rastin e sëmundjeve psikike“ (PsychKG NRW).

Mirëdita (Emri/mbiemri): \_\_\_\_\_,

dëshirojmë që t'ju ndihmojmë në mënyrë që së shpejti të ndiheni sërish mirë.

Me këtë broshurë dëshirojmë t'ju informojmë lidhur me të drejtat dhe detyrimet më të rëndësishme. Teksti i ligjit, i shkurtuar, gjendet në stacion.



## Arsyeja për akomodim

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Juve ju kanë transportuar në spital, sepse jeni i sëmurë dhe për shkak të sjelljes suaj ekziston rrezik akut për ju ose të tjerët.

Ligji që e lejon këtë quhet ligji „Për ndihmat dhe masat mbrojtëse në rastin e sëmundjeve psikike“. Shkurt „PsychKG NRW“.

## Vendimi gjyqësor (§ 14 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Nëse ju duhet të qëndroni në spital apo jo, këtë e vendos një gjyqtar/gjyqtare.

Gjyqtari/gjyqtarja vjen sot ose nesër për të folur me ju për sëmundjen tuaj. Ju mund t'ia tregoni të gjitha gjyqtarit/gjyqtares. Ju keni të drejtë të merrni një avokat/avokate.

Nëse gjyqtari/gjyqtarja nuk vjen, ju nxirreni nga spitali. Nëse mjeku/mjekja i/e trajtimit nuk nis një procedurë të re sipas ligjit për sëmundjet psikike.

Kundër vendimit të gjyqtarit/gjyqtares mund të paraqitni ankesë me shkrim pranë gjykatës brenda një afati prej dy javësh. Punonjësit e stacionit ju ndihmojnë për ngritjen e ankesës.

## Dokumentacioni – e drejta e shikimit (§ 16 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Personeli shkruan se çfarë ndodh gjatë trajtimit.

Nëse ju bëheni më mirë, masat detyruese do të diskutohen edhe një herë me ju.

Ju keni të drejtë të lexoni gjithçka që personeli ka shkruar për ju.

Kjo quhet e drejta e shikimit.

## Qëndrimi në ambient të jashtëm (§ 16 Abs. 1 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Ju keni të drejtë të dilni jashtë, në kopsht ose në tarracë, çdo ditë për të paktën një orë.

## Kontrolli mjekësor në momentin e pranimit (§ 17 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Një mjek/mjeke do t'ju vizitojë sa më shpejt të jetë e mundur.

Një mjek/mjeke kontrollon nëse ju vazhdoni të rrezikoni ende veten ose njerëzit e tjerë.

## Njoftimi i një personi të besuar (§ 17 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Nëse ju dëshironi, ne njoftojmë një person të besuar (shok, familjar, kujdestar) se ju jeni në spital.

Nëse keni një kujdestar/kujdestare ligjor/ligjore, ai/ajo informohet automatikisht.

Nëse dëshironi, ne mund të informojmë një avokat/avokate.

Këta persona mund të marrin pjesë në bisedën me gjyqtarin/gjyqtaren.

## Trajtimi (§ 18 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Sëmundja juaj mund të trajtohet tek ne. Ju do të trajtoheni vetëm nëse jeni dakord për këtë. Ky quhet pëlqim. Kjo vlen edhe për ilaçet. Nga ky rregull ka përjashtime. Trajtimi duhet të diskutohet ekzakt me ju.

#### 1. Përjashtim:

Një mjek/mjeke ka të drejtë t'ju trajtojë kundër vullnetit tuaj nëse ekziston një rrezik i madh për shkak të sëmundjes suaj. Rrezik i madh quhet rreziku për jetën për shkak të sjelljes të kushtëzuar nga sëmundja juaj kur ka rreziqe shumë të mëdha për

shëndetin për ju ose njerëz të tjerë. Si rregull, lejohet trajtimi i detyruar kur këtë e lejon një gjyqtar/gjyqtare.

#### 2. Përjashtim:

Shumë rrallë, një mjek/mjeke mund të bëjë gjithashtu një trajtim të detyruar pa e pyetur gjyqtarin/gjyqtaren. Ky është rasti kur mjeku/mjekja mendon se nuk mund të pritët derisa të vijë gjyqtari/gjyqtarja, sepse përndryshe mund të ndodhë diçka e keqe.

Të dy përjashtimet quhen trajtim i detyruar.

## Masa sigurie të veçanta (§ 20 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Nëse ju rrezikoni veten tuaj ose të tjerët veçanërisht shumë, mjeku/ mjekja mund të urdhërojë masat e mëposhtme:

- 1.) Juve nuk ju lejohet të dilni jashtë ose
- 2.) Ju dërgoheni i vetëm në një dhomë dhe dera ju mbyllet ose
- 3.) personeli ka të drejtë t'ju mbajë shtrënguar, ose
- 4.) personeli ka të drejtë t'ju lidhë në krevat.

Këto masa lejohen vetëm për aq kohë që nuk ka asgjë tjetër që ndihmon. Atyre duhet t'ju jepet fund menjëherë nëse nuk ekziston më rrezik.

Nëse ju duhet të lidheni për një kohë më të gjatë se 30 minuta, këtë duhet ta lejojë një gjyqtar/gjyqtare.

Nëse ju ndjeheni më mirë, ju mund t'i kërkoni një gjyqtari/gjyqtareje që ta kontrollojë nëse jeni lidhur me të drejtë.

## Mbarimi i akomodimit (§ 15 PsychKG und § 25 PsychKG)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Çdo ditë kontrollohet nëse akomodimi është ende i nevojshëm.

Nëse ju ndiheni më mirë, ju mund:

- të lejoheni të bëni pushime ose
- të nxirreni nga spitali ose
- të lejoni të trajtoheni më tej me vullnetin tuaj.

## Sendet personale, vizita, telekomunikacioni dhe mediat, Pirja e duhanit (§ 22 PsychKG)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Sendet e rrezikshme duhet t'ia dorëzoni infermierëve. Kur të dilni nga spitali ju i merrni sërish këto sende.

Juve ju lejohej të përdorni celularin dhe laptopin tuaj. Ju keni të drejtë të dërgoni letra. Ju keni gjithashtu të drejtë të merrni letra. Nëse dëshironi mund të pranoni edhe vizita.

Ju lutemi, merrni në konsideratë edhe njerëzit e tjerë në stacion.

Pirja e duhanit lejohej vetëm në hapësirat e parashikuara të pirësve të duhanit. Ajo është identifikuar në mënyrë të qartë.

Pa pëlqim, në klinikën LVR nuk ju lejohej të bëni foto ose regjistrime me zë të personave të tjerë.

## Kostot e trajtimit

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Nëse nuk keni sigurim shëndetësor bëjeni këtë të ditur. Me këtë ju ndihmon shërbimi social i klinikës LVR.

## Marrëveshja e trajtimit, testamenti biologjik (§ 2 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Mund të ndodhë që ju të trajtoheni sërish tek ne.

Ne do të marrim parasysh edhe një testament biologjik.

Në mënyrë që ne ta dimë se si duhet t'ju trajtojmë më së miri ju mund të bëni një marrëveshje me shkrim me mjekun/mjeken. Kjo quhet Marrëveshja e trajtimit.

Kjo marrëveshje zbatohet më vonë për të gjithë pjesëmarrësit.

## Ankesat (§ 24 PsychKG NRW)

### Informacion i shkurtër (thjeshtë për t'u kuptuar)

Nëse jeni i pakënaqur ju mund të ankoheni.

Ka edhe mundësi të tjera për ankesa (për adresën shih Shtojca):

Ka mundësi të ndryshme. Një përmbledhje varet në stacion. Ose ju pyetni personelin.

**Ju urojmë shërim të shpejtë!**  
Klinika LVR

**Shtojca:****Mundësi të ankesave**

Ju keni gjithmonë mundësinë për t'u ankuar për p.sh. për trajtimin ose për çështje të tjera.

**1. Punonjës në vend ose në stacion:**

Flisni me punonjësit e shërbimit të infermierisë, të administratës së infermierëve të stacionit apo të pavijonit ose edhe me mjekët/mjeket.

ose:

**2. Mbështetës të pavarur të pacientëve ose të ashtuquajturit avokatët në vend në klinikë:**

Për mbështetjen e pacientëve në klinikën LVR është i caktuar një avokat i pavarur, i cili ju kushton kohë dhe diskuton me ju në vend çështjen tuaj. Orarin e shërbimit si dhe numrin e telefonit të avokatit mund ta gjeni në tabelën e varur në stacionin tuaj në vend.

ose:

**3. Gjithashtu, në vend mund të kontaktoni edhe Administratën Mjekësore të Klinikës LVR, të cilët janë në dispozicionin tuaj për një bisedë pasi të caktohet një takim.**

Punonjësit e stacionit ju ndihmojnë me kënaqësi për të caktuar takimin.

Të dhënat e kontaktit të Administratës Mjekësore të Klinikës LVR:

ose:

**4. Jashtë Klinikës LVR, ankesat tuaja mund t'i drejtoni në:**

Zentrales Beschwerdemanagement des Landschaftsverbandes Rheinland (Qendra e Menaxhimit të Ankesave të Këshillit Rajonal Rheinland).



Landschaftsverband Rheinland/ ZBM  
50663 Köln  
Tel.: 0221/ 809 2255, Email: beschwerden@lv.r.de

ose:

**5. Së fundmi, ju mund t'u drejtoheni qendrave të pavarura të konsulencës për personat me përvojë psikiatrike në rajonet e ndryshme, p.sh.:**

### Rajoni Köln

Beschwerderat Psychosoziale Arbeitsgemeinschaft (PSAG) Köln  
c/o Rat und Tat e.V. Kempener Str. 135  
50733 Köln, Tel: 0163/ 383 1686, Email: beschwerderat@web.de

### Rajoni Düsseldorf

Unabhängige Beschwerdestelle Psychosoziale Arbeitsgemeinschaft (PSAK) Düsseldorf  
Kölner Str. 180, 40227 Düsseldorf  
Tel: 0211/ 899 2622 sekretaria telefonike,  
Email: psag\_beschwerdestelle@duesseldorf.de

### Rajoni Duisburg-Essen

Unabhängige Beschwerdestelle der Psychosozialen Arbeitsgemeinschaft (PSAG) Duisburg  
c/o Gesundheitsamt Herr Marcel Hellmich, Ruhrorter Straße 195,  
47119 Duisburg  
Tel: 0203/ 283 2709, Email: beschwerdestelledu@gmx.de

### Rajoni Krefeld

Psychosoziale Beschwerdestelle Krefeld  
Westwall 134, 47798 Krefeld

Tel: 02151/ 389 261 sekretaria telefonike,  
Email: beschwerdestelle@psag-krefeld.de

## Rajoni Viersen

Beschwerdestelle des Gemeindepsychiatrischen Verbundes Kreis Viersen  
Kontakt: BIS e.V., Klosterstr 5, 41379 Brüggen  
Tel: 02163/ 5622, Email: info@bis-brueggen.de

ose:

**6. Nëse jeni të mendimit se shqetësimi juaj nuk u trajtua mjaftueshëm, bazuar në nenin 30 të PsychKG, ju keni mundësinë ta drejtoni ankesën tuaj pranë qeverisë mbikëqyrëse të qarkut:**

- Bezirksregierung Köln, Krankenhausaufsicht, Postfach, 50606 Köln
- Bezirksregierung Düsseldorf, Krankenhausaufsicht, Postfach 300865, 40408 Düsseldorf

### Shënim ligjor:

Edicioni i 2-të, 2022  
Përgjegjës për përmbajtjen:  
Raporti i LVR-së 8/84.20 së bashku me 81.30  
(sektori juridik). Personi i kontaktit: Uwe  
Blücher 84.20.

### Kontribues:

Përpunuar në mënyrë trilogjike nga:  
Personat shoqërues të të shëruarëve të  
klinikave LVR, përfaqësuesit e të afërmve,  
mjekë specialistë për psikiatri dhe  
psikoterapi, sektori i infermierëve, personat  
përgjegjës publikë, administrata e projektit  
të pjesëmëm SEIB, persona përgjegjës  
për integrimin, ZBM, administratat e  
infermierëve si dhe administratat mjekësore  
të klinikave LVR, të cilët kontribuuan në  
mënyrë thelbësore për  
zbatueshmërinë praktike të kësaj broshure.

**paraqitja tekstore:** në gjuhë të thjeshtë për  
t'u kuptuar (afër komunitetit) bazuar mbi  
rregullat për gjuhë të thjeshtë (shoqata  
Netzwerk Leichte Sprache e.V.) si dhe mbi  
qarkoren administrative nr. 2 të raportit LVR  
1.

### Versionet e gjuhëve:

Broshura e PsychKG është në dispozicion në  
32 përkthime.

riprodhimi i jashtëm i broshurës është i  
mundur me shënimin e së drejtës së autorit:  
© LVR-Klinikverbund und Verbund  
Heilpädagogischer Hilfen